



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1269/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë, kundër vendimit PZAP -it Anr. 1007/2013 të datës 04.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar apeli nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 06.12.2013, nga Lëvizje Vetëvendosja për rishikim të vendimit Anr.1007/2013 të datës 04.12.2013, ku theksohet se PZAP-i nuk ka vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme bazën faktike dhe në këtë mënyrë baza për shqiptimin e gjobës nuk e ka përmbushur kushtin thelbësor që e vërteton gjendjen faktike në mënyrë të plotë. Vlenë të theksohet se administrimi i provave nuk nënkupton vërtetimin e gjendjes faktike, andaj për të njejtën nuk duhet shqyrtuar matriali që i është ofruar PZAP-it në cilësinë e provës që i është bashkalidhur përgjegjës në ankesë LVV. Ky matrial përfshinë kontratën elektronike e cila kushtëzon hapjen e llogarisë në rrjetin social Facebook dhe Twinter, dhe është kontratë e dyanshme që lidhet në momentin e hapjes së llogarisë. Po ashtu PZAP-i në asnjë vend të arsyetimit të vendimit nuk ka provuar pronësinë e llogarisë së shkelësit të supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj apeli gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës pretendimet ankimore lidhur me vendimin Anr. 1007/2013 të datës 04.12.2013, se PZAP-it nuk i ka ofruar bazën ligjor, nuk qëndrojnë sepse secili subjekt politik është përgjegjës për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes që kryhet nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, siç përcaktohet me nenin 32.5 të LZP-së. Në rastin konkret Erzen Vraniqi nga Lëvizja Vetëvendosja, ka rënë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b. në të cilin parashihet:

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshte , dhe
b) bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Siç shihet nga dispozitat e sipërshënuar ligjore nuk përcaktohet se çfarë fushate është e ndaluar apo me çka do të bëhet ajo fushatë (telefon, Facebook, Twinter etj), por theksohet se bërja e fushatës në çfardo mënyre gjatë heshtjes zgjedhore është e ndaluar andaj në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1269/2013 më datën 10.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.